



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201601220/4

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandim për ndërprerjen e veprimeve të kundërligjshme ndaj shtetasit Sh.M. dhe familjarëve të tij.*

Drejtuar : Shefit të Komisarariatit të Policisë nr. 6
Z. Neritan BOÇI

Tiranë

Për dijani : Drejtorit të Policisë së Shtetit
Z. Haki ÇAKO

Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë
Z. Ervin HODAJ

Tiranë

I nderuar zoti Boçi,

Me shkresën tonë nr. K2/SH38-2 Prot., datë 02.06.2016, ju kemi vënë në dijeni se në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi Sh.M., me banim në Rr. "Unaza e Re", Pall. "K. KO" nr. 9, H.1, Kati 10, Tiranë. Ankuesi shkruan se, ka patur në pronësi një tokë bujqësore me sipërfaqe 3000 m². Ai ka lidhur dy kontrata sipërmarrje me Shoqërinë "Kristi CO" Shpk, respektivisht nr. 7392 Rep. dhe nr. 1197 Kol., datë 05.07.2006, si dhe nr. 4408 Rep. dhe nr. 643 Kol., datë 14.06.2007, ku palët kanë rënë dakort që në tokën e shtetasit Sh.M. të ndërtohet një godinë banimi dhe shërbimesh me disa kate nga Shoqëria "K. CO" Shpk, e cila do ti kalojë atij 34 % të sipërfaqes ndërtimore totale. Nga pjesa takuese sipas kontratave të cituara më lart, ankuesi ka marrë në posedim edhe një dyqan me sipërfaqe 100 m² që ndodhet në katin përdhe. Për pronësinë e këtij dyqani ka patur pretendime edhe shtetësja A.M. e cila ka lidhur një kontratë shitblerjeje me Shoqërinë "K. CO" Shpk.

Kjo çështje është bërë konflikt gjyqësor ndërmjet ankuesit, shtetasës A.M. dhe Shoqërisë "K. CO" Shpk dhe ndërmjet tyre janë zhvilluar disa procese gjyqësore, si dhe janë dhënë disa vendime, të cilat kanë marrë formë të prerë.

Me vendimin nr. 8489 datë 19.07.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur, *rrëzimin e kërkesë padisë së shtetasës A.M. ndaj të paditurve "K. CO" Shpk dhe Sh.M.* Me vendimin nr. 948 datë 20.03.2014,

Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur, *ndryshimin e vendimit nr. 8489 datë 19.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në këtë mënyrë: Detyrimin e të paditurit Shoqërisë "K. CO" Shpk të përmbushë detyrimin kontraktor ndaj shtetases A.M. sipas kontratës së sipërmarrjes nr. 2335 Rep., dhe nr. 374/1 Kol, datë 27.12.2006. **Rrëzimin e padisë lidhur me të paditurin Sh.M.** Sqarojmë se objekti i kësaj kërkesë padie ishte detyrimi i të paditurve "K CO" Shpk dhe Sh.M. të lirojnë dhe dorëzojnë dyqanin me sip. 100 m2.*

Meqënëse vendimi ka marrë formë të prerë dhe përbën titull ekzekutiv, me vendimin nr. 2820 akti, datë 30.05.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit e vendimit nr. 8489 datë 19.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 948 datë 20.03.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Këtë vendim shtetësja A.M. e ka çuar për zbatim në Zyrën e Përmbartimit Tiranë. Ankuesi Sh.M. ka kundërshtuar në gjykatë veprimet përmbartimore dhe ka kërkuar anulimin e tyre. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 10899, datë 12.11.2014 ka vendosur, **kundërshtimin dhe anulimin pjesërisht të veprimit përmbartimor nr. 6670, datë 04.07.2014 "Kërkesë për mbështetje për ekzekutim" të Zyres së Përmbartimit Tiranë, për atë që veprim i drejtohet paditësit Sh.M..** Ndaj këtij vendimi është bërë ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr 1880, datë 08.09.2015 ka vendosur, **mos pranimin e ankimit të bërë nga pala e paditur A.M. dhe Zyra e Përmbartimit Tiranë ndaj vendimit nr. 10899, datë 12.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si të paraqitur jashtë afatit ligjor të ankimit.**

Pas kësaj, paditësi Sh.M. ka paditur Shoqërinë "K. CO" Shpk duke i kërkuar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e sipërmarrjes nr. 4408 Rep. dhe nr. 643 Kol., datë 14.06.2007, njohjen e sipërfaqeve takuese të përcaktuara në kontratë, si dhe detyrimin e të paditurit që të përmbushë detyrimin kontraktor ndaj paditësit për njohjen e 34 % të gjithë sipërfaqes ndërtimore të pallatit për sipërfaqet shtesë të ndërtuara. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 6839, datë 21.09.2015 ka vendosur rrëzimin e padisë së paditësit Sh.M.. Ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 498 datë 08.03.2016 ka vendosur, **ndryshimin e vendimit nr. 6839, datë 21.09.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pranimin e kërkesë padisë, detyrimin e palës së paditur Shoqërisë "K. CO" Shpk të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e sipërmarrjes nr. 4408 Rep. dhe nr. 643 Kol., datë 14.06.2007. Detyrimin e palës së paditur Shoqërisë "K. CO" Shpk të përmbushë detyrimin kontraktor ndaj paditësit Sh.M. për 34 % të gjithë sipërfaqes ndërtimore të pallatit për sipërfaqet shtesë të ndërtuara.**

Mirëpo sipas ankuesit, megjithëse me vendimet gjyqësore në lidhje me këtë dyqan është vendosur në favor të tij, prej disa kohësh punonjësit e Komisarariatit të Policisë nr. 6 Tiranë i krijojnë shqetësime, duke i thënë që të lerë dyqanin dhe t'ja dorëzojë atë shtetases A.M.. Hera e fundit që punonjësit e policisë i kanë shkuar në dyqan ishte në datën 24.05.2016, në orën 12:30. Në këtë datë, dy punonjës të policisë e kanë shoqëruar atë dhe motrën e tij, S.I., nga dyqani në Komisarariatin e Policisë nr. 6 Tiranë me pretendimin se kanë bërë vetëgjyqësi. Në komisarariat ata janë takuar me Shefin e Komisarariatit dhe OPGJ Isa Ahmetaj dhe i kanë dhënë informacionin e plotë rreth këtij problem, si dhe i kanë paraqitur edhe vendimet gjyqësore lidhur me këtë konflikt.

Ankuesi pretendon se, ndonëse drejtuesi i komisarariatit dhe OPGJ i kanë parë e lexuar vendimet gjyqësore, nuk janë tërhequr nga qëndrimi i tyre, se ai ka bërë vetëgjyqësi dhe se, nëse do ta hapë dyqanin do ta fusnin në burg.

Gjithashtu ankuesi pretendon se, megjithëse problemi i tij u sqarua brenda një kohë të shkurtër, ata janë mbajtur në komisariat deri në orën 18:00. Gjithashtu ankuesi shkruan se, nuk ka kryer vetëgjyqësi sikurse pretendon policia, si dhe nuk ka kryer asnjë veprë penale. Sipas tij, veprimet e policisë ndaj tij janë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me ligjin dhe me vendimet gjyqësore të cituara më sipër dhe bëhen me qëllim për të favorizuar padrejtësisht shtetasen A.M..

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese dhe sqaruar pretendimet e ankuesit, bazuar në pikën 4, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *"Organet dhe funksionarët publike janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij"*; në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe konkretisht, në nenin 19, gërma "b" ku parashikohet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin"*; si dhe në nenin 19, paragrafi i fundit, ku parashikohet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme"*, me shpresën e cituar më sipër ju kërkuam të verifikoni këtë rast dhe na dërgoni shpjegime brenda 5 ditëve nga data e mbërritjes së kësaj shkrese lidhur me:

1. A janë të vërteta pretendimet e ankuesit të përshkruara më sipër?
2. Nëse po, cili është shkaku dhe baza ligjore e kryerjes së këtyre veprimeve policore ndaj ankuesit lidhur me pronësinë e dyqanit të cituar më lart.
3. Cila është arsyeja dhe baza ligjore e shoqërimit në polici të ankuesit dhe motrës së tij në datën 24.05.2016?
4. Çfarë veprimesh janë kryer nga punonjësit e policisë lidhur me ta.

Ndonëse afati ligjor i kthimit të përgjigjes kërkesës tonë kaloi, ju nuk na e dërguat atë. Mosdërgimi i përgjigjes brenda afatit ligjor ka sjellë moskorrektesën e institucionit tonë ndaj ankuesit për shqyrtimin në kohë të kësaj ankese.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se, mosdërgimi i përgjigjeve për kërkesat e dërguara nga Institucioni i Avokatit të Popullit është rast tipik i refuzimit të një funksionari publik për të bashkëpunuar me këtë institucionin në përmbushjen e misionit të tij kushtetues e ligjor.

Pas bërjes së ankesës, ankuesi dhe dy motrat e tij janë paraqitur edhe dy herë të tjera në institucionin tonë dhe kanë ngritur pretendimin se veprimet e kundërligjshme të policisë ndaj tyre vazhdojnë ende.

Megjithëse në mungesë të përgjigjes tuaj, nga shqyrtimi i kësaj ankese dhe dokumentacionit të administruar nga ana jonë ndërmjet të cilave edhe disa vendime gjyqësore të cituara më sipër, rezulton se:

1. Konflikti ndërmjet ankuesit Sh.M., shtetasen A.M. dhe Shoqërisë "K. CO" Shpk në lidhje me pronësinë e një dyqani me sipërfaqe 100 m² që ndodhet në katin përdhe është një konflikt civil dhe jo penal. Për rrjedhojë organet e policisë nuk kanë asnjë të drejtë ligjore që të ndërhyjnë dhe të kryejnë veprime në lidhje me këtë problem.

2. Megjithatë ky konflikt, për të cilin janë zhvilluar disa procese gjyqësore ndërmjet palëve të citura më lart, si dhe janë dhënë disa vendime, të cilat kanë marrë formë të prerë, tashmë është zgjidhur në mënyrë përfundimtare nga organi kompetent, gjykata. Ndërkohë ju sjellim në vëmendje nenin 142/3 të

Kushtetutës tonë, në të cilit parashikohet se: *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”*.

3. Theksojmë se, nga ankesa dhe nga përmbajtja e të gjitha vendimeve gjyqësore të cituara më sipër rezulton e provuar se ankuesi Sh.M. e ka poseduar në fakt dyqanin objekt i konfliktit gjyqësor. Për rrjedhojë, hapja apo shfrytëzimi i këtij dyqani prej tij nuk përbën ndonjë vepër penale dhe nuk ka asnjë nga elementët edhe të figurës së veprës penale të “Vetëgjyqësisë”, për të cilën ai është shoqëruar në komisariat dhe pyetur nga punonjësit e policisë apo i bëhet padrejtësisht presion prej tyre.

4. Veprimet e punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr. 6 Tiranë duke i bërë presion që të lirojë dhe dorëzojë dyqanin me sipërfaqe 100 m2 shtetases A.M., ose nëse do të hapte dyqanin do ta fusnin në burg për vetëgjyqësi, apo shoqërimi në komisariat i tij dhe i motrës së vet shtetases S.I. me pretendimin se kanë bërë vetëgjyqësi, janë të kundërligjshme, të njëanshme dhe me qëllim për të favorizuar padrejtësisht shtetasen A.M..

Ndodhur në këto rrethana, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21/b të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*;

REKOMANDOJMË :

Ndërprejen e menjëhershme të veprimeve të kundërligjshme të punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr. 6 Tiranë ndaj shtetasit Sh.M. dhe familjarëve të tij në lidhje me dyqanin me sipërfaqe 100 m2, kati përdhe, i ndodhur në Rr. “Unaza e Re”, Pall. “K. KO” nr. 9, Tiranë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda 30 ditëve konform nenit 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI